

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E HËNË 5 DHJETOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Për anëtarësimin në Bashkimin Europian Shqipëria duhet dhe ka detyrimin të plotësojë një detyrim të fortë të dispozitës së BE-së për cilësinë e ujit dhe të ajrit, për menaxhimin e mbetjeve, për mbrojtjen e natyrës, ndotjet nga kimikatet e të tjera. Po të dëgjosh retorikën e të nderuarit, Kryeministrit tonë Edi Rama, për mjedisin, edhe pse je opozitar, të jep një farë ndjesie pozitive dhe thua, i korruptuar është sa të duash, por të paktën mjedisin e do të pastër.

Po ju citoj disa thënie të Kryeministrit Rama ndër vite: “Patriotizmi tregohet duke mbajtur pastër vendin dhe jo me pushkë. Dëmtimi i mjedisit është tradhti kombëtare”. Por, kur viziton zonën naftëmbajtëse të Fierit, e kupton fare mirë që ky Kryeministër atdhedashës, pastërtor e patriot, i cili jep edhe shembullin personal, duke i mbledhur plehrat pa dorashka, toleron me qëllim një bandë bukëshkalësh e tradhtarësh që janë angazhuar 24 orë në 24 për veprimtarinë kriminale të ndotjes së qëllimshme dhe sistematike të Shqipërisë për përfitime personale. Lumenjtë e Gjanicës dhe të Vjosës, të nderuar kolegë, vazhdojnë të ndoten prej shumë vjetësh ende edhe sot nga industria e naftës. Kompani koncesionare private dhe kompania publike “Albpetrol”, pasi e ndajnë naftën nga uji, në vend që ta trajtojnë ujin sipas standardeve që kërkon Bashkimi Europian dhe që mundëson industria moderne e naftës, e derdhin atë nga dekantimet direkt në lumenjtë Gjanicë e Vjosë.

Derdhja e këtij uji të mbushur me kimikate të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut në lumenjtë e Gjanicës dhe Vjosës kryhet nga dekantimet e Visokës, Usojës, Qafës së Kashit, Mollajt dhe Gorishtit. Këto nuk janë impiante industriale, por skema të qarta krimi mjedisor dhe burime sëmundjesh e mutacionesh, të cilat tashmë kanë nisur të japin efektin e tyre në popullsinë e zonave dhe të fshatrave që prekin. Ndikimi në mjedis, por edhe në jetën dhe mirëqenien e banorëve të zonës së Fierit i këtij aktiviteti është vrastar, ku mbi 30 qytete dhe fshatra me gati 250 mijë banorë të bashkive Fier, Patos dhe Mallkastër ndikohen drejtpërdrejt nga avujt toksikë që lëshojnë lumenjtë e Gjanicës dhe Vjosës në

dimër dhe në verë. Me dhjetëra bizneseve të turizmit dhe peshkatarëve në bregdetin e Semanit, Darëzës dhe Pish Poros u prishet puna dhe u plas shpirti, por për më tepër u përkeqësohet shëndeti, megjithatë ata heshtin nga frika, sepse ato pak të ardhura që nxjerrin i kanë për bukën e gojës së tyre dhe familjeve të tyre.

Shëndeti i dhjetëra e mijëra pushuesve që vijnë për të marrë jodin, që ofrojnë plazhet e Adriatikut në zonën e Fierit, sabotohen dhe komprometohen pa dijeninë e tyre nga këto derdhje kriminale. Nëse kjo do të ndodhte në një vend të Bashkimit Europian, do të ishte skandali i shekullit në raport me turistët. Skema kriminale e ndotjes mbulohet nga propaganda bashkiake dhe qeveritare, të cilat i çajnë rrjetet sociale me qëllim që t'u veshin sytë dhe mendjen qytetarëve. Kjo propagandë ka si qëllim t'u ofrojë qytetarëve një realitet tjetër nga ai që është në të vërtetë, por betonimi i lumit Gjanica nuk mund ta fshehtë dëmin shëndetësor të vazhdueshëm.

Po ta shikoni me vëmendje dhe të hapni Facebook-un e Bashkisë së Fierit, herë pas here ose shumë shpesh do të gjeni postime për Gjanicën e rilindur, Gjanica dikur dhe tani, Gjanica që më parë përmytej, ndërsa tani e zbutur që rrjedh e qetë dhe e rrethuar nga sistemi urban dhe gjelbërimi, por, në fakt, këto janë përralla, sepse tashmë Gjanica, së cilës i është bashkuar edhe Vjosa, është kthyer në lumin e vdekjes, një qefin që rrjedh në mes të qytetit, një varr i hapur që po ua bën gropën të gjithë fierakëve me ndotjet toksike të industrisë së naftës. Pak ditë më parë pata rastin t'i vizitoja, duke i parë edhe nga larg këto pika shkarkimi, të cilat po jua tregoj. Është ky këtu.

Të nderuar qytetarë,

Sa herë që Gjanicës i vjen era naftë, dikush shkel ligjin, por ligji sfidohet, një zyrtar i shtetit është korruptuar, blerë ose është vënë në gjumë me para korrupsioni. Drejtuesit e këtyre kompanive jo se nuk kanë para dhe mundësi për të investuar dhe për të dhënë fonde për të përmirësuar kushtet e punës dhe për ta trajtuar ujin e nxjerrë nga nëntoka, por ata zgjedhin në mënyrë kriminale dhe me dashje që ta bëjnë këtë gjë. Ata preferojnë që fondet t'i drejtojnë në tendera ku të ndajnë pjesën me miqtë e tyre të mafies dhe me politikanët sesa të trajtojnë ujin dhe të mos bëjnë dëme të riparueshme për dekada të tëra. Agjencia Rajonale e Mjedisit në Fier, në Vlorë dhe në Mallakastër i ka zyrat 10 metra nga brigjet e Gjanicës, por, çuditërisht, i ka hundët e zëna për të nuhatur ndotjen dhe sytë e zënë për të parë ndotjen.

Por, edhe po të duan të bëjnë diçka, kanë vetëm 4 inspektorë, pa instrumente, vetëm me duar në xhepa, me teserën e Partisë Socialiste në xhep, sigurisht nuk mund të bëjnë dot asgjë. Mbi 250 mijë qytetarë të qarkut të Fierit janë pre e zullumit të ndotjes mjedisore dhe politike. Ndotja, të dashur

qytetarë, nuk është abstrakte, ndotja ka emër, ka emrin e drejtorit të Albetrolit, kryetarit të bordit drejtues të Albetrolit, drejtoreshës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ministres Mirela Kumbaro, Bashkisë së Fierit, Bashkisë së Patosit, Roskovecit dhe Mallakastrës.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Kjo qeveri nuk di të ndalet, e ka filluar, në fakt, duke na vjedhur xhepat, por po e vazhdon duke na e marrë edhe shpirtin. Faleminderit!